



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSh. nr. 149/2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, dhe nenin 17 sipas procesverbalit të bordit të OSHP, të 30.09.2022, për Amandamentim të Rregullores Nr.01/2020, me (Nr. protokollit 83/2022), pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik OE "Petra Plast L.L.C" Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i Objekteve shkollore –Shkollat dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës" me Nr. Prokurimit AP: 616-23-781-2-1-1, iniciuar Komuna e Prishtinës në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK), Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj-Mexhuani me 28.04.2023 mori këtë:

VENDIM

1.Hedhet si e pa lejuar ankesa OE "Petra Plast L.L.C" Prishtinë, e datës 20.03.2023 (protokoll 149/2023) e ushtruar për aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i Objekteve Shkollore – Shkollat dhe Institucionet Parashkollore në Komunën e Prishtinës" me numër të prokurimit: AP: 616-23-781-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Prishtinës.

2.I lejohet autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës, që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pastrimi i Objekteve Shkollore –Shkollat dhe Institucionet Parashkollore në Komunën e Prishtinës" me numër të prokurimit: AP: 616-23-781-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Prishtinës, përkitazi me këtë ankesë nëse nuk ka ankesë tjetër .

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Autoriteti kontraktues me 09.03.2023, ka publikuar formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, ku në bazë të këtij formulari afati i fundit për dorëzim të ofertave për aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i Objekteve Shkollore –Shkollat dhe Institucionet Parashkollore në Komunën e Prishtinës” me numër të prokurimit AP: 616-23-781-2-1-1, iniciuar nga Komuna e Prishtinës në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK).

Operatori ekonomik (OE) “Petra Plast L.L.C” Prishtinë, me datën 20.03.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK dhe me të njëjtën datë me 20.03.2023 AK kishte marr vendim me të cilin e kishte refuzuar kërkesën si të pa lejuar, ngase e njëjta është vlerësuar se është parashtruar jashtë afatit ligjor për kërkesë.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE “Petra Plast L.L.C” Prishtinë e datës 20.03.2023 (protokoll 149/2023) e ushtruar për aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi i Objekteve shkollore –Shkollat dhe Institucionet Parashkollore në Komunën e Prishtinës” me numër të prokurimit AP: 616-23-781-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Prishtinës, është e pa lejuar ngase Ankuesi ka humbur afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim, Oshp sqaron se afati i fundit për dorëzimin ofertave ka qenë data 20.03.2023, kurse kërkesën për rishqyrtim Ankuesi e kishte parashtruar me dt.20.03.2023 e cila ishte dita e hapjes së ofertave.

Rrjedhimisht sqarimet e më sipërme rrjedh se Ankuesi ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim në ditën e hapjes së ofertave, e jo *Brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave*, siç kërkohet me nenin 108/A të LPP-së dhe nenin 60 pika (a) të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik. Oshp vlerëson se AK me të drejt kërkesën e datës 20.03.2023 të këtij operatori ekonomik e kishte hedhur si të pa lejuar, me arsyetimin se e njëjta ishte ushtruar jashtë afatit ligjor në kundërshtim me nenin 108/A të LPP cituar:3.1: *në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;*

Prandaj për ankesën e OE “Petra Plast L.L.C” Prishtinë të ushtruar në OSHP konstaton se ankesa e parashtruar hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP ngase ankuesi kërkesën për rishqyrtim e kishte parashtruar në kundërshtim me paragrafin 3 pika 1 të nenit 108/A të Ligjit për Prokurim Publik, si dhe në kundërshtim me nenin 60 pika (a) të Rregullores Nr.001/2022.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e OSHP
Vjosa Gradinaj - Mexhuni

The image shows a circular official stamp of the Office of the State Prosecutor of Kosovo (OSHP). The stamp contains the text "REPUBLIKA E KOSOVES" at the top, "PROKURORIA E SHTATUTIT I PROKURIMIT" around the inner edge, and "PRISHTINE" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Kosovo. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë me padi, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK Komuna e Prishtinës
- 1x1 OE "Petra Plast L.L.C" Prishtinë
- 1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së